



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 8 regjistër (JR)  
Datë 07.02.2020

Nr. 28 i vendimit  
Datë 27.09.2021

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Relator</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 27.09.2021, në orën 10:00, ditën e mërkurë, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 8/2020, datë 07.02.2020, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Arben Vrioni, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 214, datë 22.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Vrioni.

**BAZA LIGJORE:** Neni 62 e vijues, neni 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe avokatin e tij Sokol

Hazizaj, të cilët përfundimisht kërkuan ndryshimin e vendimit nr. 214, datë 22.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Arben Vrioni, dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Vrioni (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Më parë, në funksion dhe për zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1; 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas të cilave ka rezultuar:

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport<sup>1</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
- (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

2.3 Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit,

---

<sup>1</sup> Raporti i ILDKPKI-së nr. {\*\*\*} prot., datë 06.02.2018.

sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLD-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në kriterin e pasurisë dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 214, datë 12.11.2019.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

4. Komisioni, me vendimin nr. 214, datë 12.11.2019, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Vrioni, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.*
5. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

**5.1.** Në lidhje me vlerësimin e pasurisë: *Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror, konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve; (ii) ngrihen dyshime të arsyeshme se subjekti nuk ka deklaruar vlerën reale të blerjes së automjetit në pronësi të tij, duke kryer në mënyrë indirekte fshehje të pasurisë; dhe (iii) ngrihen dyshime të arsyeshme se subjekti ka deklaruar një marrëdhënie fiktive huaje, me qëllim mbulimin e të ardhurave të pajustificuara që kanë shërbyer për shkollimin e vajzës së tij. Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (1) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara; dhe (2) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.*

## **III. Mbi ankimin dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit**

6. Më datë 31.01.2020, subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë Komisionit ankimin kundër vendimit nr. 214, datë 22.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me të cilin është njoftuar më datë 18.01.2020. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor sipas nenit 63<sup>2</sup>, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Bashkëngjitur ankimit, subjekti i rivlerësimit dorëzoi edhe provat e renditura si më poshtë.

---

<sup>2</sup> Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

- (i). Dokumentacioni "Llogari në letra me vlerë për privatizimin, lëshuar nga Banka e Kursimeve në emër të T.H", si vlerë e dhënë për kompesimin pasuror të ish të përndjekurve dhe të dënuarve politikë nga sistemi komunist.
- (ii). Kontratë shitjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.02.2004, të realizur midis B.G në cilësinë e shitësit dhe I.S në cilësinë e blerësit, sipas së cilës pasuria nr. {\*\*\*}, e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}” të qytetit të Elbasanit, është shitur në vlerën 3.800.000 lekë.
- (iii). Akti ekspertimit i kryer nga eksperti kontabël i licensuar A.Q.

### ***Lidhur me shkaqet e ankimit me natyrë procedurale***

**6.1** Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se në procesin e tij të rivlerësimit, janë marrë për bazë të dhënat e marra në hetimin administrativ vetëm për komponentin e vlerësimit të pasurisë (të parashikuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016), si dhe në seancën dëgjimore të zhvilluar për këtë qëllim. Zhvillimi i këtij procesi hetimor administrativ, nga ana e këtij organi, vetëm për këtë komponent, ka bërë që të shkelen hapur parimet dhe parashikimet ligjore të shprehura qartë në Kushtetutë, si dhe në ligjin organik të dalë për këtë qëllim.

**6.2** Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Ky vendim është tërësisht i paragjykuar sepse është rrjedhojë e një procesi hetimi e gjykimi në shkelje të parimeve të së drejtës, ku i njëjti subjekt procedural, Komisioni, ka kryer si hetimin administrativ, ashtu edhe gjykimin.

**6.3** Subjekti ka pretenduar në ankim se vendimi është marrë nga një trupë gjykuese që nuk plotëson kriterin kushtetues të një gjykate të caktuar me ligj, pasi vetëm mënyra e krijimit të saj si organ kushtetues është e drejtë dhe ligjore, por në thelb të këtij organi asnjëri nga anëtarët e tij nuk plotëson kriterin kushtetues dhe ligjor, atë të qenies gjyqtar, fakt që bie ndesh me nenin 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë", nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), për rrjedhojë është një vendim nul.

**6.4** Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është rrjedhojë e një procesi hetimi e gjykimi në shkelje të parimeve të së drejtës, për sa i përket barrës së provës, të cilën ia ka kaluar subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, duke e detyruar atë të provojë të kundërtën e dyshimeve dhe konstatimeve të Komisionit, me prova që i përkasin një periudhe të gjatë kohe, jo vetëm nga fillimi i punës si gjyqtar, por edhe para kësaj periudhe.

**6.5** Subjekti i rivlerësimit në ankim, ka pretenduar se Komisioni kalon edhe kompetencat e tij, duke marrë edhe atributet e mjekut kardiolog dhe të përcaktimit të gjendjes së tij shëndetësore, ku sipas trupit gjykues të Komisionit është konkluduar se, duke qenë se koha e problemeve shëndetësore është pesë muaj më parë, nuk merret në konsideratë pretendimi për gjendjen

jooptimale shëndetësore, si dhe duke i rrëzuar kërkesën për t'u paraqitur me mbrojtës ligjor (avokat).

6.6 Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, pasi është nënshkruar vetëm nga dy anëtarë të trupës gjyquese, duke mos u nënshkruar nga anëtarja tjetër, pjesë e trupit gjykues A.F, të cilin sipas subjektit e bën atë nul dhe të pavlefshëm. Nga aktet bashkëngjitur këtij vendimi dhe pikërisht nga procesverbali i vendimmarrjes së Komisionit, pasqyrohet se vendimi për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është marrë në mënyrë unanime, por kjo nuk presupozon që komisionerja e cila nuk ka nënshkruar në vendim, të jetë plotësisht dakord me arsyetimin e vendimit dhe prej saj të mos ketë ndonjë qëndrim paralel, në lidhje me të gjitha gjetjet e arsyetuara në këtë vendim. Ndaj ky vendim është i pavlefshëm, parë kjo edhe në vështrim të dispozitave procedurale të gjykimeve të çështjeve administrative dhe atyre civile.

6.7 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se nuk është dakord me argumentimin e Komisionit në vendim, se subjekti nuk ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, duke bërë kërkesa të vazhdueshme të pabazuara në prova e në ligj, të cilat mund të përbënin shkak për zvarritjen e procesit të rivlerësimit. Lidhur me këtë shkak, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se u është përgjigjur të gjithë pyetësorëve të Komisionit, rezultateve të hetimit, ka sjellë dokumente etj., duke listuar edhe datat e dërgimit të përgjigjeve me *e-mail*.

### ***Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë***

7. Lidhur me pasurinë “apartament banimi”, me sipërfaqe 157 m<sup>2</sup>, e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konstatimi i Komisionit se deklarimi i tij gjatë procesit të hetimit administrativ nuk është në harmoni me provat e administruara nga Komisioni, pasi pasuria në vitin 2004 është regjistruar në emër të I. L.T, është i padrejtë.

7.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza e kryer nga Komisioni në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 157 m<sup>2</sup>, të blerë në vlerën 6.000.000 lekë, është e gabuar. Sipas subjektit të rivlerësimit, nëse pasuria që ka shërbyer si burim krijimi i apartamentit 157 m<sup>2</sup>, do të ishte blerë në shumën 4.500.000 lekë sipas dyshimit të Komisionit, atëherë nuk do të kishte logjikë që të shitej në vlerën 1.900.000 lekë në vitin 2002.

7.2 Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, konvertimin e vlerës 31.143 USD, nga të ardhurat nga shitja e pasurisë së nënës, të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni duhej ta konvertonte me kursin mesatar të muajit qershor 1997, sipas Bankës së Shqipërisë, ku 1 USD = 179,06 lekë, kurs sipas të cilit vlera e konvertuar do të rezultonte 938.338 lekë më shumë se përlllogaritja e Komisionit, i cili e ka këmbyer shumën në dollarë me kursin 1 USD = 148,93 lekë.

7.3 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se në lidhje me shpenzimet e mobilimit të deklaruar nga ai në pyetësorët e Komisionit, në vlerën 700.000 lekë, nuk mund të konsiderohen si një shpenzim i ndarë nga shpenzimet e jetesës sepse janë pjesë e tyre. Subjekti i rivlerësimit pretendon që shpenzimet e mobilimit të konsiderohen zero dhe në analizën që ka paraqitur, nuk i ka vendosur këto shpenzime.

7.4 Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se është provuar në mënyrë të plotë se znj. A.M ka pasur burime të ligjshme për krijimin e vlerës 1.000.000 lekë, të cilat ia ka dhuruar vajzës së saj, znj. M.V, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ndaj konkluzioni i Komisionit për mospërfshirjen e kësaj shume, si përfitim nga shitja e pasurisë së trashëguar, është i pabazuar në prova dhe në ligj. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është provuar se çmimi 500.000 lekë i shitjes së pasurisë së ndodhur në lagjen “{\*\*\*}” të qytetit të Elbasanit, nga trashëgimtarët e V. H te B. G, është joreal në raport me përmbajtjen e deklaratës noteriale të këtij të fundit dhe çmimit të referencës së shitjes së pasurive të paluajtshme për qytetin e Elbasanit, pasuri e cila është shitur në vlerën 4.800.000 lekë.

7.5 *Lidhur me pasurinë autoveturë tip Benz Mercedes, me targë {\*\*\*}, të blerë me vlerë 12.000 USD, sipas kontratës me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 10.10.2016, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se nuk ka pasur shoqëri apo nuk ka gjykuar asnjë çështje penale apo civile të ngritur prej P.Ç apo ndaj tij. Për këto arsye, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ekziston asnjë lloj dyshimi që të ketë përdorur këto lidhje për përcaktimin e çmimit të këtij sendi. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky mjet nuk është zhdoganuar prej tij dhe ai nuk ka pasur dijeni për mënyrën e krijimit të kësaj pasurie nga P.Ç.*

7.6 *Lidhur me transfertat e kryera nga nëna e subjektit të rivlerësimit, në favor të shtetasit B. D, subjekti kundërshton përfundimet e Komisionit duke shpjeguar se vlera e transferuar nga nëna e subjektit, në shumën prej 35.000 USD, nuk ka të bëjë me vlerën 25.000 GBP, që kunati i tij i ka dërguar për shkollimin e vajzës. Vlera 35.000 USD është vlerë që ka sjellë shtetasi B.D dhe familjarët e tij në Shqipëri, e përfituar nga shitja e një shtëpie në pronësi të tyre.*

7.7 *Lidhur me analizën financiare për vitet 2005, 2007 dhe 2009, subjekti i rivlerësimit përkatësisht për vitin 2005 ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit është i njëanshëm në interpretimin e provave, nuk është proporcional dhe është interpretim i gabuar i ligjit. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni në mënyrë të njëanshme ka hequr nga analiza financiare e vitit 2005 vlerën prej 500.000 lekësh, të krijuar si kursim *cash* të deklaruar në vitin 2004, kursim ky i deklaruar në deklaratën periodike vjetore që i përket periudhës së vitit 2005, me arsyetimin se vlera nuk është deklaruar *cash* në fund të vitit 2004 nga subjekti i rivlerësimit.*

8. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ankimit, kërkon:  
*Ndryshimin e vendimit nr. 214, datë 22.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.  
Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Vrioni.*

#### IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

###### i. Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### ii. Legjitimimi i ankuesit

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 214, datë 22.11.2019, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

11.1 Gjatë shqyrtimit në dhomë këshillimi, u konstatua se shkak i ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt ligjor në drejtim të mosgarantimit të zbatimit të dispozitave procedurale, u gjend i drejtë, dispozitivi i vendimit ishte nënshkruar nga të tre anëtarët, ndërsa mungesa e nënshkrimit të vendimi i plotë, duket se afektonte vetëm pjesën arsyetuese të tij, pasi rezultoi i nënshkruar vetëm nga dy anëtarë të trupës gjyqësore, duke mos u nënshkruar nga anëtarja tjetër A.F. Trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm, pa ia kthyer çështjen për rishqyrtim me qëllim korigjimin e gabimit procedural të kryer nga ana e Komisionit, konkretisht, mungesës së nënshkrimit të një prej anëtareve të trupit gjykues të Komisionit në vendimin objekt shqyrtimi, dhe për t’i garantuar subjektit të rivlerësimit mbrojtjen e të drejtave të tij themelore, në

përputhje me nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, vendosi të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore publike, në praninë e subjektit të rivlerësimit për ta dëgjuar dhe për t’u mbrojtur për çështjen e tij. Për këtë qëllim, seanca publike u caktua në datën 15.09.2021, ora 10:00. Në këtë mënyrë, trupi gjykues zgjidhi pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me shkeljen procedurale nga ana e Komisionit në kuadër të procesit të rregullt ligjor, edhe pse vlerësohet se mungesa e nënshkrimit në vendim të njërit prej anëtarëve të Komisionit, nuk afektonte të gjithë vendimin objekt shqyrtimi.

*B. Mbi aspektet procedurale lidhur me provat dhe kërkesat e subjektit të rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancë publike, Kolegji konstatoi si më poshtë.*

12. Në seancën gjyqësore publike të datës 15.09.2021, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj, duke u qëndruar shkaqeve të ankimit të tij, u shpreh se në qoftë se trupi gjykues i Kolegjit i ka të gjitha provat edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, t’i vlerësojë ato, ose në të kundërt të prishë vendimin dhe të marrë vlerësim edhe për dy kriteret e tjera.
13. Subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet e tij të depozituara në Kolegj në seancën e datës 15.09.2021, fillimisht në kërkesat paraprake nëpërmjet avokatit, kërkoi konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, kërkesë të cilën trupi gjykues i Kolegjit e konstatoi se nuk hyn në kuadrin e kërkesave paraprake dhe e ftoi subjektin e rivlerësimit dhe avokatin e tij të vijojnë me pretendimet rreth procesit të rivlerësimit. Më pas, u kërkua riçelja e hetimit gjyqësor sipas nenit 51, germa “c” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe marrjen në shqyrtim në seancë gjyqësore të provave të depozituara prej tij, të cilat u pranuan nga Kolegji në këtë seancë gjyqësore dhe renditen si më poshtë.

1- Shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 14.06.2021, e shkollës 9-vjeçare “{\*\*\*}” dhe kërkesa e subjektit të rivlerësimit drejtuar këtij institucioni.

2- Shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 18.06.2021, e shkollës 9-vjeçare “{\*\*\*}” dhe kërkesa e subjektit të rivlerësimit drejtuar këtij institucioni.

3- Shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 21.06.2021, e Zyrës Vendore Arsimore Elbasan dhe kërkesa e subjektit të rivlerësimit drejtuar këtij institucioni.

4- Ortofoto, nga aplikacioni "Google Maps", ku pasqyrohet vendndodhja e pallatit nr. {\*\*\*}, lagjja “{\*\*\*}”, dhe e shkollës 9-vjeçare “{\*\*\*}”.

5- Shkresa nr. {\*\*\*}, datë 18.09.2019, e Ujësjetllës Kanalizime Elbasan, bashkëngjitur kësaj shkrese janë pasqyruar pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit deri në muajin gusht të vitit 2019.

6- Kontratë për furnizimin me energji elektrike për konsumatorë të kategorisë familjare, të lidhur midis Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe Arben Vrionit, datë 04.03.2003, bashkëngjitur:

i- Faturë tatimore shitjeje nr. {\*\*\*}, datë 29.01.2003.

ii- Akti "Furnizim me energji elektrike", datë 29.01.2003.

7- Raport analiza financiare e kryer nga audituesi ligjor O.V.



8- Procesverbale të datave 11.11.2014, 27.11.2014, 09.12.2014 mbi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së.

9- Deklaratë noteriale me nr. rep. {\*\*\*}, dhe nr. kol. {\*\*\*}, datë 13.09.2021, e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

10- Vërtetime nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Elbasan, për përfitimet nga pensionet e prindërve të subjektit, me nr. {\*\*\*}, datë 07.09.2021.

11- Shkresë nr. {\*\*\*}, datë 9.07.2021, e Shoqërisë {\*\*\*} (dhe kërkesa e subjektit drejtuar këtij institucioni), bashkëngjitur së cilës:

i- Kontratë Abonimi, datë 09.10.2002.

ii- Kërkesë e datës 03.10.2002, e M.V për transferim të linjës telefonike.

iii- Kontratë Pajtimi me nr. {\*\*\*}, datë 15.12.2003.

iv- Kontratë për shërbimin "{\*\*\*}" nr. {\*\*\*}, datë 17.11.2008 dhe anekset bashkëngjitur.

v- Amendamenti i kontratës së shërbimit ADSL, datë 29.06.2012.

vi- Formular për regjistrimin e përdoruesit të kontratës së pajtimit, datë 10.12.2015.

vii- Kontratë e pajtimit me {\*\*\*} nr. {\*\*\*}, datë 10.12.2015.

viii- Shkresë nr. {\*\*\*}, datë 01.07.2021, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega Elbasan.

ix- Certifikatë përbërje familjare e shtetasit M.R, datë 15.07.2021.

14. Kolegji çeli hetimin gjyqësor për të hetuar faktet e pretenduara në ankim, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të paraqesë prova dhe të shpjegohet në lidhje me to. Bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancë publike në Kolegji, të listuara më sipër, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i mbështetur ato, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Kolegji vendosi të lejojë marrjen dhe nënshkrimin e tyre debatit gjyqësor e më pas i vlerësoi ato në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit. Pasi u vlerësuan edhe provat e reja të sjella nga subjekti i rivlerësimit, në formën e kërkuar nga ligji, të cilat iu nënshtruan debatit gjyqësor, Kolegji arriti në konkluzionet e mëposhtme.

*C. Mbi thelbin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit*

15. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim, se në procesin e tij të rivlerësimit janë marrë për bazë të dhënat e marra në hetimin administrativ vetëm për komponentin e vlerësimit të pasurisë (të parashikuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016), si dhe në seancën dëgjimore të zhvilluar për këtë qëllim. Zhvillimi i këtij procesi hetimor administrativ, nga ana e këtij organi, vetëm për këtë komponent, ka bërë që të shkelen hapur parimet dhe parashikimet ligjore të shprehura qartë në Kushtetutë, si dhe në ligjin organik të dalë për këtë qëllim.

15.1 Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, duke iu referuar nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të*

*procedurave*. Pra, vendimi në procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit mund të merret bazuar në një ose disa prej kritereve të rivlerësimit, që do të thotë se nëse në një moment të caktuar të zhvillimit të procedurës hetimore administrative nga ana e Komisionit, ky i fundit arrin në përfundimin se ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit bazuar në rezultatet e arritura nga procedura për vlerësimin edhe vetëm të një kriteri, ligji e lejon Komisionin të mbyllë procedurën e rivlerësimit për atë kriter, mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit, dhe të marrë një vendim për shkarkimin e subjektit, pa qenë e nevojshme që procedura administrative të vazhdojë më tej me verifikimin e kritereve të tjera.

**15.2** Kur Komisioni çmon se provat kanë një nivel të tillë provueshmërie sipas parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, lexuar në harmoni me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe interpretimi logjik i nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që bëjnë të besohet se subjekti i rivlerësimit gjendet para prezumimit ligjor të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, atëherë është e mundur vendimmarrja për një ose dy kritere. Pavarësisht vendimit që mund të merret në këtë fazë, për të mbyllur hetimin administrativ mbështetur vetëm mbi një ose dy kritere, Komisioni, në funksion të zhvillimit të një procesi të drejtë e në respektim të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar e mbrojtur, mundet ta revokojë këtë vendimmarrje pas kryerjes së seancës dëgjimore e analizës së pretendimeve të subjektit krahas provave të administruara nga hetimi dhe të vazhdojë procedurën hetimore administrative edhe për komponentët e tjerë. Ndërkohë që parashikimi i nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 kërkon që, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet detyrimisht të vlerësojë tri kriteret në mënyrë kumulative. Në nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, është mirëpërcaktuar se, me qëllim konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, kërkohet që ai të plotësojë kushtet e kërkuara për tri kriteret, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

**15.3** Në funksion të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, del i qartë interpretimi që institucionet e rivlerësimit mund ta marrin vendimin mbi bazën e një kriteri vlerësimi ose të disa kritereve, si dhe në vlerësimin e tri kritereve apo në vlerësimin e përgjithshëm të tyre, ose në vlerësimin tërësor të procedurave të një ose disa kritereve të rivlerësimit, qëndrim ky i mbajtur në jurisprudencën<sup>3</sup> e Kolegjit. Komisioni dhe Kolegji kanë të drejtë për të konkluduar me vendim, qoftë edhe vetëm për njërin nga kriteret dhe, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, konkretisht për kriterin e pasurisë, Kushtetuta parashikon shkarkimin nga detyra për ato raste të deklarimit të pasurisë të parashikuara në këtë dispozitë, siç është përpjekja për të fshehur apo paraqitja në mënyrë të pasaktë e pasurive. *Për sa më sipër, shkak i ankimit i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar.*

---

<sup>3</sup> *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 9/2018 (JR), paragrafi 44; nr. 11/2018 (JR), paragrafi 5; nr. 2/2019 (JR), paragrafi 35.2; nr. 15/2019 (JR), paragrafi 119; nr. 34/2019 (JR), paragrafi 55.1; nr. 20/2020, paragrafët 14.1, 14.2, 14.3.*

16. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Ky vendim është tërësisht i paragjykuar sepse është rrjedhojë e një procesi hetimi e gjykimi në shkelje të parimeve të së drejtës, ku i njëjti subjekt procedural, Komisioni, ka kryer si hetimin administrativ, ashtu edhe gjykimin. Ky fakt bie ndesh tërësisht me parimin kushtetues e ligjor për gjykimin nga një gjykatë e paanshme. Gjithashtu vendimi i Komisionit është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, sepse trupa e Komisionit ka cenuar parimin e garantimit të paanshmërisë, pasi në seancën dëgjimore të datës 20.11.2019, nga subjekti i rivlerësimit është kërkuar përjashtimi i trupit gjykues, për shkak se ka bërë rivlerësimin vetëm për sa i përket kriterit të pasurisë duke paracaktuar vendimmarrjen në lidhje me këtë proces.

16.1 Nga procesverbali i seancës dëgjimore, rezulton se Komisioni i ka dhënë subjektit të gjitha mundësitë dhe garancitë për t'u mbrojtur, duke i dhënë të drejtën të paraqesë shpjegime dhe deklarata në lidhje me: i) vlerësimin e provave; ii) rezultatet e hetimit; dhe iii) kalimin e barrës së provës për të provuar të kundërtën e asaj çka ka rezultuar nga hetimi administrativ. Gjithashtu, anëtarët e trupit gjykues kanë plotësuar deklaratat për mungesë konflikti interesi me subjektin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon detyrimin e institucioneve të rivlerësimit për të ushtruar funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues, për shkak se është vënë në dyshim paanësia e gjykimin dhe është cenuar procesi i rregullt ligjor, sepse është rivlerësuar vetëm për një kriter, atë të pasurisë. Sa i përket rivlerësimit vetëm për kriterin e pasurisë, si i vetmi shkak i kërimit të përjashtimit të trupit gjykues nga subjekti i rivlerësimit, Kolegji për sa ka arsyetuar edhe më sipër, vlerëson se ky shkak ankimi është i pambështetur në ligj.

16.2 Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit, për të shqyrtuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e trupit gjykues, një tjetër trupë gjykuese ka vendosur me vendimin nr. {\*\*\*}prot., datë 20.11.2019, dhe se shkaqet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk bëjnë pjesë në shkaqet e parashikuara në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016 dhe ato të parashikuara në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative. Gjithashtu, kjo trupë ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit nuk vërtetoi se ekzistojnë shkaqet për përjashtim sipas ligjit dhe se ushtrimi i detyrës funksionale dhe mënyra e interpretimit dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, nuk përbën paragjykim dhe cenim të paanësisë së trupit gjykues dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përbëjë shkak për përjashtimin e kësaj trupe.

16.3 Në vlerësimin e elementit të paanësisë së gjyqtarit, Kolegji mbështetet edhe në qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese<sup>4</sup> dhe atë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të

---

<sup>4</sup> *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.46, datë 19.07.2016; nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 21, datë 29.04.2010; nr.12, datë 13.04.2007.*

Njeriut<sup>5</sup>, sipas së cilave ekzistenca e paanësisë duhet të vlerësohet në bazë të dy kritereve, atij të vlerësimit subjektiv, sipas të cilit duhet të merret në konsideratë bindja personale dhe sjellja e gjyqtarit, domethënë nëse ky i fundit ka shfaqur ndonjë paragjykim apo qasje personale, dhe atij të vlerësimit objektiv, sipas të cilit duhet siguruar nëse gjykata, në drejtim të përbërjes së saj, ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në lidhje me paanësinë e saj.

**16.4** Në kuadër të vlerësimit objektiv, është e nevojshme që të verifikohet nëse ekzistojnë fakte të cilat ngrenë dyshime mbi paanësinë e komisionerëve. Kjo nënkupton se, për të përcaktuar nëse në një çështje ka një arsye legjitime për t'u shqetësuar se një anëtar apo një trup gjykues tregon mungesë paanësie, këndvështrimi i personit të interesuar është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Vendimtare është nëse ky shqetësim i palës mund të justifikohet në mënyrë objektive. Sa i takon vlerësimit subjektiv, GjEDNj-ja i ka qëndruar vazhdimisht parimit se “paanësia personale e gjyqtarit duhet të merret e mirëqenë deri në momentin kur provohet e kundërta”. Subjekti i rivlerësimit nuk identifikoi rrethana konkrete apo sjellje subjektive dhe qëndrime qortuese për anëtarët e Komisionit gjatë hetimit administrativ, si rrjedhojë shkaku i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.

17. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankimi se vendimi është marrë nga një trupë gjykuese që nuk plotëson kriterin kushtetues të një gjykate të caktuar me ligj, pasi vetëm mënyra e krijimit të saj si organ kushtetues është e drejtë dhe ligjore, por në thelb të këtij organi asnjëri nga anëtarët e tij nuk plotëson kriterin kushtetues dhe ligjor, atë të qenies gjyqtar, fakt që bie ndesh me nenin 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë" dhe nenin 6 të KEDNj-së, për rrjedhojë është një vendim nul.

**17.1** Në lidhje me këtë shkak ankimi, vlerësohet se pretendimi i ngritur lidhur me mospërmbushjen e kritereve ligjore për zgjedhshmërinë në detyrë të komisionerëve, tejkalon kompetencat juridikionale të Kolegjit. Në këto kushte, nuk konstatohen nga Kolegji, fakte apo rrethana të tjera në drejtim të mosformimit të rregullt të trupit gjykues, që do ta bënin vendimmarrjen e Komisionit të cenueshme në drejtim të pavarësisë apo paanësisë së saj, vlerësuar kjo në kuadër të rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe jurisprudenca e GjEDNj-së, pretendimi i subjektit nuk gjendet i bazuar në ligj.

**17.2** Në vazhdim të analizës së këtij shkak ankimi, konstatohet se një pretendim i tillë për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit si pasojë e mungesës në përbërje të tij të anëtarëve të cilët vijnë nga sistemi gjyqësor, është trajtuar së fundmi edhe nga GjEDNj-ja, e cila në vendimin e saj lidhur me çështjen gjyqësore Xhoxhaj k. Shqipërisë ka arsyetuar: [...] *Për sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih Oleksandr Volkov). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve*

---

<sup>5</sup>Fey kundër Austrisë, 1993; Wettstein kundër Zvicrës, 1996; Pullar kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1996; Micallef kundër Maltës, 2009; Kyprianou kundër Qipros, 2005.

*dhe prokurorëve. Sidoqoftë, gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kishte pushtuar sistemin e drejtësisë. [...] Sipas këndvështrimit të gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces.*

Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin. Ajo vëren se këta anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj. Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. GjEDNj-ja në vijim ka arritur në konkluzionin se nuk gjen evidencë të mungesës së pavarësisë së Komisionit, si pasojë e mospasjes në përbërje të tij të anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke mos konstatuar për rrjedhojë shkelje të nenit 6 të KEDNj-së. *Lidhur me sa më sipër, shkaku i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.*

18. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është rrjedhojë e një procesi hetimi e gjykimi në shkelje të parimeve të së drejtës, për sa i përket barrës së provës të cilën ia ka kaluar subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajsisë, duke detyruar subjektin të provojë të kundërtën e dyshimeve dhe konstatimeve të Komisionit, me prova që i përkasin një periudhe të gjatë kohe, jo vetëm nga fillimi i punës si gjyqtar, por edhe para kësaj periudhe, ndërkohë, kur me rregullimet ligjore të kohës, por edhe me ligjet në fuqi, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur dhe nuk ka aktualisht asnjë detyrim ligjor për të ruajtur këto prova, përveç dhe faktit të njohur botërisht që funksionimi i shtetit shqiptar në këtë periudhë kohore, ka qenë me probleme të theksuara të informalitetit, moszbatimit korrekt të ligjit, pothuajse nga të gjitha subjektet. Pra, gjykuar në këto rrethana, subjekti pretendoi se kalimi i barrës së provës është dukshëm antikushtetues e në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajsisë.

**18.1** Edhe lidhur me këtë shkak ankimi, sjellim në vëmendje qëndrimin e GjEDNj-së në çështjen Xhoxhaj k. Shqipërisë (paragrafët 325 dhe 326), ku është arsyetuar se: *neni 6 i Konventës nuk përcakton asnjë rregull mbi pranueshmërinë e provave ose mënyrën e vlerësimit të tyre, që për këtë arsye janë kryesisht çështje për rregullim nga legjislacioni i brendshëm dhe gjykatat vendase (shih, mes shumë autoriteteve të tjera, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata 1999-I). U takon gjykatave vendase të vlerësojnë rëndësinë e provave të parashtruara, vlerën e tyre provuese dhe barrën e provës (shih Centro Europa 7 Srl dhe Di Stefano kundër Italisë [GC], nr. 38433/09, paragrafi 198, Gjykata 2012, dhe Lady SRL kundër Republikës së Moldavisë, nr. 39804/06, paragrafi 27, 23 Tetor 2018). E drejta për një proces të drejtë ligjor siç garantohet nga neni 6/1 i Konventës përfshin të drejtën e palëve në proceset gjyqësore për të paraqitur çdo parashtrim që ata e konsiderojnë të rëndësishëm për çështjen e tyre. Qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta teorike ose imangjinare, por të drejta praktike dhe efektive, e drejtë kjo që mund të shihet të jetë efektive vetëm nëse parashtrimet “dëgjohen” me të vërtetë, domethënë, konsiderohen siç duhet nga gjykatat vendase. Me fjalë të tjera, efekti i nenit 6 është, ndër të tjera,*

*për ta detyruar “gjykatën” për të kryer shqyrtimin e duhur të parashtrimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa paragjykuar vlerësimin e saj nëse ato janë apo jo të rëndësishme (Perez kundër Francës [GC], nr. 47287/99, paragrafi 80, GjEDNj 2004-I).*

**18.2** Në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor”. Në nenin 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, te “Barra e provës”, parashikohet se Komisioni dhe Kolegji i Apelimit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit. Sipas dispozitave referuese, parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit orientojnë vlerësimin në tërësi të çështjes me synimin që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkëlqjen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Për më tepër, Neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon kalimin e barrës së provës subjektit të rivlerësimit vetëm në këtë proces administrativ, duke u përjashtuar nga çdo proces tjetër, në veçanti ai penal.

**18.3** Në këto rrethana, Komisioni e ka informuar subjektin e rivlerësimit për gjetjet e tij paraprake dhe i ka kaluar atij barrën e provës për të provuar të kundërtën. I takonte plotësisht subjektit të rivlerësimit të përgatiste më mirë mbrojtjen dhe të siguronte çdo dokument në mbështetje të mbrojtjes së tij. Ishte detyrë e subjektit të rivlerësimit të tregonte se kishte ndërmarrë të gjithë hapat për të siguruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij, në përfundim të të cilave Komisioni do të përcaktonte nëse mosmarrja e ndonjë dokumenti mbështetës ishte justifikuar për shkaqe të arsyeshme. Një garanci e tillë procedurale është futur për të trajtuar situatën e pas viteve ‘90 në Shqipëri dhe kishte garantuar, duke respektuar parimin e proporcionalitetit, një vlerësim diskret të secilës problematikë nga institucionet e rivlerësimit, pa penguar ose prishur përfundimin me sukses të procesit të rivlerësimit. *Sa më sipër, shkaku i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk është i bazuar në ligj.*

- 19.** Subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se Komisioni kalon edhe kompetencat e tij, duke marrë edhe atributet e mjekut kardiolog dhe të përcaktimit të gjendjes së tij shëndetësore, ku sipas trupit gjykues të Komisionit është konkluduar se, duke qenë se koha e problemeve shëndetësore është pesë muaj më parë nga seanca publike e zhvilluar në Komision, nuk merret në konsideratë pretendimi për gjendjen jooptimale shëndetsore, si dhe duke i rrëzuar kërkesën për t’u paraqitur me mbrojtës ligjor (avokat). Në pjesën aresyetuese të vendimit objekt ankimi, megjithëse parashtrohet kërkesa e subjektit për të shtyrë seancën dëgjimore, për të ushtruar të drejtën e tij të mbrojtjes me avokat, pasi për më tepër gjendej edhe në kushte jooptimale shëndetësore, kjo trupë që shqyrtonte çështjen vendos për rrëzimin e kërkesës për shtyerjen e seancës, duke i mohuar sipas tij, këtë të drejtë të sanksionuar në Kushtetutë, në nenin 6/c të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

**19.1** Nga dokumentacioni i administruar në dosje, vërehet se subjekti i rivlerësimit gjatë zhvillimit të seancës së datës 20.11.2019, ka kërkuar ndërprerjen e seancës për shkak të pamundësisë për

vazhdimin e saj si rrjedhojë e gjendjes shëndetësore, për shkak të së cilës Komisioni i la kohë në dispozicion subjektit të rivlerësimit që të paraqesë dokumentacionin justifikues që dëshmon për gjendjen e tij shëndetësore. Në datën 20.11.2019, subjekti i rivlerësimit dorëzoi nëpërmjet postës elektronike, dokumentacion të skanuar, si: raporte mjekësore dhe fletëdalje nga {\*\*\*}, të cilat i përkasin periudhës 15-18 qershor 2019. Pas administrimit të këtyre provave, Komisioni konstatoi se dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit provonte gjendjen shëndetësore të subjektit të rivlerësimit gjatë muajit qershor 2019 dhe nuk disponohej asnjë provë për pamundësinë e tij aktuale (në kohën e zhvillimit të gjykimit në Komision) për të vazhduar seancën dëgjimore. Si rrjedhojë, Komisioni, me vendimin nr. 10, datë 20.11.2019, me të drejtë vendosi të mos pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit me arsyetimin se ka pasur kohë të mjaftueshme që në fillim të procesit të rivlerësimit, që të ushtronte këtë të drejtë. Gjithashtu, nga procesverbali i seancës dëgjimore të datës 20.11.2019, rezulton se subjekti i rivlerësimit është vënë në dijeni nga kryesuesja e trupit gjykues të Komisionit për të drejtën për t'u mbrojtur me avokat, e cila ka konstatuar që subjekti nuk po e ushtron këtë të drejtë, dhe këtë fakt e ka pohuar në këtë seancë edhe subjekti i rivlerësimit.

**19.2** Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar në dosje, konstatohet se gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni e njohu subjektin e rivlerësimit me gjetjet paraprake pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të marrë nga institucione të ndryshme. Ky informacion që subjekti i rivlerësimit mori pas përfundimit të hetimit administrativ, duhet t'i kishte mundur atij që të kuptonte seriozitetin e gjetjeve paraprake, me qëllim përgatitjen e mbrojtjes së përshtatshme sipas vlerësimit të gjendjes së tij shëndetësore, me ose pa përfaqësues/avokat. Subjektit të rivlerësimit, pasi iu komunikuan nga Komisioni rezultatet e hetimit shtesë (11.11.2019), iu mundësua akses në dokumentacionin e çështjes, duke i lënë afat deri më datë 14.11.2019, të drejtë të cilën subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk e ka ushtruar. Gjatë seancës së datës 20.11.2019, sipas procesverbalit të seancës dëgjimore, vërehet se subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe dy kërkesa të tjera, fillimisht kërkesën për rihapjen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, të kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional, e cila, pasi iu refuzua nga Komisioni, subjekti menjëherë kërkoi po në të njëjtën seancë përjashtimin e trupit gjykues. Në vijim të së njëjtës seancë, subjekti i rivlerësimit kërkoi të mbrohet me avokat për shkak të kushteve shëndetësore të cilat i dinte prej pesë muajsh, kërkesë e cila është përsëritur në të njëjtën seancë, duke shfaqur sjellje që krijojnë bindjen se ai me çdo kusht tentonte të zvarriste procesin. Në përfundim të analizës më sipër, nuk evidentohet shkelje e procesit të rregullt nga Komisioni, si rrjedhojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.

- 20.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, pasi është nënshkruar vetëm nga dy anëtarë të trupës gjykuese, duke mos u nënshkruar nga komisionerja A.F, çka, sipas subjektit, e bën atë “nul” dhe të pavlefshëm. Nga aktet bashkëngjitur këtij vendimi dhe pikërisht nga procesverbali i vendimmarrjes së Komisionit, pasqyrohet se vendimi për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është marrë në mënyrë unanime, por kjo nuk presupozon që komisionerja e cila nuk ka nënshkruar në vendim, të jetë plotësisht dakord

me arsyetimin e vendimit dhe prej saj të mos ketë ndonjë qëndrim paralel, në lidhje me të gjitha gjetjet e arsyetuara në këtë vendim. Ndaj ky vendim është i pavlefshëm, parë kjo edhe në vështrim të dispozitave procedurale të gjykimeve të çështjeve administrative dhe atyre civile.

**20.1** Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se procesverbali i vendimmarrjes së trupit gjykues, i cili është mbajtur në datën 22.11.2019, ora 9:00, sipas të cilit është vendosur shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë procesverbal është pasqyruar se kanë qenë të pranishëm vëzhguesi ndërkombëtar, kryesuesja, relatorja e çështjes, si dhe anëtarja e trupit gjykues A.F. Votimi për këtë vendim është shënuar “unanim”, si dhe është firmosur nga tre anëtarët e trupit gjykues. Po në seancën e shpalljes së vendimit (në procesverbal, si dhe CD audio), e mbajtur në të njëjtën datë (22.11.2019), tek e cila subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i pranishëm, kryesuesja ka bërë prezent trupin gjykues të Komisionit dhe vëzhguesin ndërkombëtar.

**20.2** Konstatohet se në datën 17.01.2020, trupi gjykues që ka shqyrtuar çështjen e subjektit të rivlerësimit Arben Vrioni, ka mbajtur procesverbal konstatimi në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, për mungesën e anëtares së trupit gjykues A.F. Në të informohet se procesverbali mbahet për konstatimin e mungesës për shkaqe të agravuara shëndetësore, për të cilat anëtarja nuk mund të jetë prezente, si dhe duke qenë se afati ligjor 30-ditor i publikimit të vendimit ka kaluar. Në këtë procesverbal, është shënuar se anëtarja F. ka mbajtur qëndrimin e saj në lidhje me vendimmarrjen e kësaj çështjeje dhe gjithashtu në rrugë elektronike, i është dërguar për njohje vendimi i arsyetuar, për të cilin është përgjigjur se është dakord, duke konfirmuar kështu dakordësinë në lidhje me përmbajtjen e vendimit për publikim. Në vendimin objekt shqyrtimi, rezulton se kjo anëtare nuk ka firmosur vendimin e arsyetuar. Si rrjedhojë, për këtë qëllim, Kolegji, në përputhje me nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, vendosi, si edhe më sipër arsyetohet, të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore publike, me praninë e subjektit të rivlerësimit për ta dëgjuar dhe për t’u mbrojtur për çështjen e tij.

**21.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se nuk është dakord me argumentimin e Komisionit në vendim se subjekti nuk ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, duke bërë kërkesa të vazhdueshme të pabazuara në prova e në ligj, të cilat mund të përbënin shkak për zvarritjen e procesit të rivlerësimit. Lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se u është përgjigjur të gjithë pyetësorëve të Komisionit, rezultateve të hetimit, ka sjellë dokumente etj., duke listuar edhe datat e dërgimit të përgjigjeve me *e-mail*.

**21.1** Në lidhje me këte shkak ankimi, siç edhe më sipër arsyetohet (në paragrafët 19.1 dhe 19.2), gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nga trupi gjykues i Kolegjit, është evidentuar tendenca e subjektit të rivlerësimit për zvarritjen e procesit të rivlerësimit të tij, dhe me të drejtë Komisioni nuk e ka vlerësuar bashkëpunues subjektin e rivlerësimit, sipas kërkesave të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.



*Në lidhje me shkaqet e ankimit dhe vlerësimin e tyre mbi kriterin e kontrollit të pasurisë*

22. Për pasurinë “apartament banimi”, me numër pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe 157 m<sup>2</sup>, e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, e blerë në vitin 2002, në vlerën 6.000.000 lekë, regjistruar në ZVRPP-në Elbasan me kontratën e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 31.08.2015, rezultoi si në vijim.
23. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim për këtë pasuri, se konstatimi i Komisionit se deklarimi i tij gjatë procesit të hetimit administrativ, nuk është në harmoni me provat e administruara nga Komisioni, pasi pasuria në vitin 2004 është regjistruar në emër të I.L.T, është i padrejtë. Sipas subjektit të rivlerësimit, ai e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2003, pavarësisht se nuk e ka pasur të regjistruar në pronësi të tij dhe, nëse nuk do ta kishte deklaruar, edhe pse kishte kryer pagesat për blerjen e saj, kjo sipas tij do të mund të konsiderohej një fshehje pasurie. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e Komisionit janë arritur pa marrë në konsideratë provat e paraqitura prej tij në lidhje me ndërtuesin I.T.

**23.1** Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri: *Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera deri më 31.12.2003.*

**23.2** Referuar deklaratës së parë të interesave pasurorë (në vijim “DIPP”) të vitit 2003, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit apartament 3+1, 157 m<sup>2</sup>, të blerë nga firma “{\*\*\*}” ShPK, në vlerën prej 6.000.000 lekësh, të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Bulevardi “{\*\*\*}”, pallati nr. {\*\*\*}, Elbasan. Subjekti i rivlerësimit, si burim krijimi, ka deklaruar: (1) pjesërisht kursimet e tij; dhe (2) pjesën më të madhe me të ardhurat e përfituara nga shitjet e pasurisë së nënës.

**23.3** Në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë *vetting* (në vijim “deklarata *vetting*”), subjekti i rivlerësimit, si burim krijimi të kësaj pasurie, ka deklaruar vetëm të ardhurat e përfituara nga nëna e tij nga shitja e pasurive në qytetin e Gjirokastrës, pa përfshirë këtu kursimet e tij si burim krijimi të kësaj pasurie të deklaruar në deklaratën e para fillimit të detyrës në vitin 2003.

**23.4** Kolegji konstaton se, nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se nëpërmjet kontratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.08.2015, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasit I. dhe E.T, pasurinë e llojit apartament me sipërfaqe 157 m<sup>2</sup>, e regjistruar në ZVRPP Elbasan, me adresë të pasurisë në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan. Në këtë kontratë është përcaktuar se çmimi i shitjes prej 6.000.000 lekësh është likuiduar dhe pasqyruar sipas mandateve: nr. {\*\*\*}, datë 02.02.2003 – shuma prej 1.400.000 lekësh; nr. {\*\*\*}, datë 03.07.2002 – shuma prej 4.000.000 lekësh; nr. {\*\*\*}, datë 10.07.2003 – shuma prej 600.000 lekësh. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë që në deklaratën fillestare të vitit 2003 dhe blerja e pasurisë sipas kontratës noteriale daton në vitin 2015, Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit se përse mandatpagesat e paraqitura për pagesën e këtij apartamenti, datojnë në 2002-shin dhe 2003-shin, nëse blerja ka ndodhur në vitin 2015, pyetje së cilës subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur: *Mandatpagesat datojnë në 2002 dhe 2003, sepse në vitin 2002 ne kemi lidhur një kontratë sipërmarrjeje me firmën “{\*\*\*}” ShPK për blerjen e pasurisë në pallatin nr. {\*\*\*}, shk. {\*\*\*}, k. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, në vlerën 6.000.000 lekë, vlerë të cilën e kemi shlyer sipas faturave të cilat ju i dispononi. Edhe pse ne filluam të banojmë në këtë apartament në shtator të vitit 2002 dhe vazhdojmë të banojmë dhe sot, kjo pasuri është hipotekuar nga subjekti ndërtues vetëm në vitin 2015, kur ne dhe banorët e tjerë të pallatit u pajisëm dhe me certifikatën e pronësisë, pasi marrja*

*e lejes së shfrytëzimit nga Zyra e Urbanistikës u zgjat në kohë, për shkaqe të panjohura për ne. Ky është shkaku që kontrata e blerjes daton në vitin 2015.*

**23.5** Nga dokumentacioni që rezulton i administruar në dosjen e Komisionit, ZVRPP-ja Elbasan konfirmon<sup>6</sup> se në emrin e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, figuron e regjistruar pasuria me nr. {\*\*\*}, volum {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, zonë kadastrale {\*\*\*}, e llojit apartament me sipërfaqe 157 m<sup>2</sup>. Nga verifikimi i dosjes së kësaj pasurie, në kartelën e pasurisë vërehet se, më datë 01.04.2004, kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasit I.L.T dhe, më datë 16.01.2007, është lëshuar certifikata e pronësisë në emër të tij. Më datë 01.09.2015, është regjistruar kjo pasuri në emrin e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij dhe po në të njëjtën datë është lëshuar certifikata e pronësisë.

**23.6** Në dosjen e Komisionit rezulton e administruar kontrata e sipërmarrjes, e lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, e cila nuk ka datë për të vërtetuar lidhjen e kontratës, por në nenin 5 të saj parashikohet se do të paguhet shuma 4.000.000 lekë në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur kësaj kontrate mandatpagesën me nr. {\*\*\*}, datë 03.07.2002, sipas së cilës ka paguar shumën e cituar më sipër, me shënimin “për blerje shtëpie”. Kontrata e sipërmarrjes dhe mandati i pagesës janë kopje të njësuara me origjinalin nga noteri, vërtetimi i së cilës mban nr. {\*\*\*} rep., datë 19.09.2019.

**23.7** Nga analiza e këtij shkaku ankimi, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri që në momentin e deklarimit fillestar të vitit 2003, duke treguar vlerën e blerjes, si dhe mandatet e arkëtimit sipas kësteve që ka paguar. Gjithashtu e ka deklaruar edhe në deklaratën *vetting*. Pavarësisht se fitimin e pasurisë e ka formalizuar me kontratë shitblerjeje në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar që në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes. Ajo që nuk përputhet me provat e administruara gjatë procesit administrativ, është deklarimi i subjektit të rivlerësimit në pyetësin nr. 2 në lidhje me regjistrimin e kësaj prone nga ana e shoqërisë në vitin 2015, ndërkohë që administratori i shoqërisë, sipas konfirmimit të ZVRPP-së Elbasan, e ka regjistruar apartamentin që në vitin 2004, shënuar në kartelën e pasurisë. Si rrjedhojë, rezulton një mospërputhje e përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësin nr. 2 dhe dokumentacionit të administruar në këtë proces, sa i përket arsyes së sjellë nga subjekti se përse kontrata e shitblerjes është lidhur kaq vonë në kohë, krahasuar me momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, por kjo situatë faktike nuk sjell pasojë negative për subjektin e rivlerësimit në këtë proces.

- 24.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza e kryer nga Komisioni në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 157 m<sup>2</sup>, të blerë në vlerën 6.000.000 lekë, është e gabuar. Sipas subjektit të rivlerësimit, nëse pasuria që ka shërbyer si burim krijimi i apartamentit 157 m<sup>2</sup>, do të ishte blerë në shumën 4.500.000 lekë sipas dyshimit të Komisionit, atëherë nuk do të kishte logjikë që të shitej në vlerën 1.900.000 lekë në vitin 2002. Sipas tij (subjektit), vlera e përfituar nga shitja e apartamentit 1.900.000 lekë, në datën 05.03.2004, duhet të konsiderohet në favor të pagesave të blerjes së apartamentit në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK (me vlerë 6.000.000 lekë), pasi sipas subjektit të rivlerësimit, edhe pse kjo kontratë është materializuar në vitin 2004, pagesa është bërë në vitin 2002 nga blerësi M.R. Lidhur me apartamentin e prenotuar nga nëna e subjektit të rivlerësimit, ky i fundit pretendon se, për shkak të pamundësisë së shitësit (I.H) për të liruar banesën deri në datën e përcaktuar në kontratën e kaparit të lidhur më 30.05.2000, ia ka kthyer kaparin nënës së subjektit të rivlerësimit, ndaj nuk duhet të konsiderohet si i humbur.

---

<sup>6</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 08.02.2019.

**24.1** Komisioni ka konstatuar gjatë hetimit administrativ se deklaramet e subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri, janë kontradiktore pasi në deklaratën *vetting*, si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga nëna e tij nga shitja e pasurive në qytetin e Gjirokastrës, ndërsa në deklaratën fillestare të pasurisë së vitit 2003 ka deklaruar (i) kursimet e tij dhe të bashkëshortes, si dhe (ii) të ardhurat nga shitjet e pasurisë së nënës, pra dy burime.

**24.2** Lidhur me këtë mospërputhje, Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit në pyetësorin nr. 2, nëse ka kontribut në blerjen e kësaj pasurie, i cili në përgjigjen e datës 17.09.2019, u përgjigj se: *Kontributi im për blerjen e kësaj pasurie është në masën e 1.000 000 lekëve. Këto lekë ishin të kursyera nga mua dhe bashkëshortja ime nga puna jonë ndër vite.* Gjithashtu, në të njëjtin pyetësor të Komisionit, pyetjes se përse kontrata e depozituar pranë ILDKPKI-së mban vitin 2000 dhe kontrata e shitjes nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., është e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur: *Kontrata e depozituar pranë ILKDPI e vitit 2000, është kontrata e blerjes së apartamentit në pallatin {\*\*\*}, {\*\*\*}, me 3 dhoma dhe 1 kuzhinë në lagjen “{\*\*\*}”, e cila iu ble I.H. Ky apartament, në të cilin ne jetuam vetëm 2 vite, iu shit M.R në vitin 2002 de fakto (de jure në 2004) po me të njëjtën vlerë të blerjes. Shitja e këtij apartamenti shërbeu si burim i blerjes së pallatit {\*\*\*}, shk. {\*\*\*}, k. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, në po këtë lagje. Kontrata e vitit 2000 është depozituar për faktin e vërtetimit të burimit të blerjes së pasurisë pallati {\*\*\*}, shkalla nr. {\*\*\*}, kati {\*\*\*}, apartamenti {\*\*\*}, si dhe për faktin se në ZVRPP ekzistonte akoma në pronësinë tonë ky apartament, pavarësisht se ne nuk jetonim më aty dhe aty jetonte që prej shtatorit 2002 M. R, kontrata e blerjes së të cilit u finalizua në vitin 2004. Kontrata e shitjes së pasurisë në pallatin nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, lagjja “{\*\*\*}”, u finalizua në 05.03.2004, pasi në këtë moment blerësi M.R pagoi dhe vlerën e mbetur pa paguar prej 200.000 lekësh.*

**24.3** Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, mënyra e blerjes së pasurisë nga subjekti i rivlerësimit rezultoi e tillë që më parë është lidhur një kontratë kapari me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} volt. akt., datë 27.11.1999, si një ndër burimet e pasurisë “apartament banimi me sip. 157 m<sup>2</sup>”. Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit, rezultoi se me kontratën nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., më datë 13.11.1996, nëna e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e bashkëpronares, ka shitur pasurinë e llojit shtëpi banimi 3-katëshe dhe truallin rreth saj, ndodhur në Gjirokastrë, në vlerën prej 400.000 USD. (Pjesa takuese e saj, sipas kontratës së shitjes, është në masën e 3/21 pjesë, përlllogaritur në vlerën 57.143 dollarë).

Në datën 27.11.1999, nëna e subjektit të rivlerësimit ka lidhur kontratën e kaparit me shtetasin I.H, për shitblerjen e pasurisë së llojit shtëpi banimi dhe truallit përkatës, të përbërë nga tri dhoma e një kuzhinë, ndodhur në pallatin nr. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, sipas së cilës është dhënë kapari prej 1.500.000 lekësh për të garantuar shitblerjen e pasurisë, ku në total, vlera e përcaktuar e shitjes është shuma prej 4.500.000 lekësh. Referuar kontratës së kaparit, të dyja palët (shitësi kaparmarrës dhe blerësja kapardhënëse) deklarojnë se kanë rënë dakord që z. I. H, këtë shtëpi banimi, së bashku me të gjitha shtesat që ka bërë (2 ballkone), si dhe me të gjitha pajisjet e shtëpisë, do t’ia shesë blerëses, znj. H.V, të përfshira në vlerën 4.500.000 lekë.

**24.4** Kolegji vëren se në kontratën e kaparit, parashikohet se të dyja palët ranë dakord dhe deklaruan se kontrata e shitblerjes ndërmjet tyre për këtë shtëpi, truallin e saj dhe pajisjet, do të bëhet brenda

datës 30.05.2000, dhe se palët janë marrë vesh në përputhje me nenet 601<sup>7</sup> dhe 602<sup>8</sup> të Kodit Civil. Në rast se kontrata e shitblerjes nuk bëhet me kushtet e përshkruara në kontratën e kaparit, dhe kur kjo nuk realizohet për fajin e blerëses kapardhëse, znj. H.V, kjo e fundit e humbet këtë kapar. Pra, përveçse në kontratën e kaparit është referuar neni 602 i Kodit Civil, është cituar edhe në kontratë, për të siguruar detyrimet e palës kapardhëse, me qëllim mbarëvajtjen e kontratës, që kur marrëveshja nuk ekzekutohet për fajin e palës që ka dhënë kapar, kjo e fundit e humbet kaparin, ndërsa në rast se nuk ekzekutohet për fajin e palës kaparmarrëse, kjo palë detyrohet t'i japë dyfishin e kaparit që i ka marrë jashtë zyrës së noterisë palës tjetër.

**24.5** Nga dokumentacioni i administruar në dosje, nuk është e qartë se për fajin e cilës palë nuk u ekzekutua kontrata, por rezulton se më datë 17.07.2000, është lidhur kontrata me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., e shitblerjes së kësaj pasurie (pasurisë për të cilën ishte dhënë kapari nga ana e nënës së subjektit të rivlerësimit), me vlerë totale prej 1.900.000 lekësh, ku si palë blerëse rezulton subjekti i rivlerësimit dhe palë shitëse I.H. Nga veprimet kontraktore, kuptohet se shitësi ka pasur vullnetin e plotë për ta shitur këtë pasuri edhe pas mospërmbushjes së kontratës së shitjes që sigurohej nga kontrata e kaparit.

Referuar kësaj kontrate, citohet: *Shitësi I.H deklaron se pasurinë që ka në pronësi të tij ia shet blerësit, z. Arben Vrioni, përkundrejt vlerës prej 1.900.000 lekësh, të cilat deklaron se i ka marrë të gjitha në dorë nga blerësi Arben Vrioni jashtë kësaj zyre noterie, të numëruara.*

**24.6** Lidhur me këto mospërputhje të rezultuara, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës nëpërmjet rezultateve të hetimit, datë 05.11.2019, i cili në prapësimet e datës 10.11.2019, ka sqaruar se: *Kapari i dhënë nga nëna H. V për shtëpinë, është konsideruar i humbur nga ana juaj, gjë e cila nuk është e vërtetë. Nga ju është përcaktuar apriori fajësia, edhe pse nuk ka pasur një të tillë. [...] Vlera prej 1.500.000 lekësh (si kapar i kthyer) është pjesë e vlerës 1.900.000 lekë me të cilën është blerë apartamenti, pra I. H përveç kaparit të kthyer prej tij, i është dhënë vlera prej 400.000 lekësh. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse kontrata e kaparit është paraqitur si provë nga unë. Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, paraqiti në Komision deklaratën noteriale me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 09.11.2019, të I.H, nëpërmjet së cilës ky i fundit deklaron se ka lidhur një kontratë kapari me znj. H.V, nga e cila ka marrë kapar në shumën 1.500.000 lekë, për të garantuar nëpërmjet kontratës shitblerjen e apartamentit ku ishte përcaktuar dhe afati 30.05.2000. Z. H. deklaron se, në pamundësi për të liruar banesën, është dakordësuar me znj. V. për kthimin pa pasoja të vlerës së kaparit. Lidhur me vlerën provuese të deklaratës noteriale, sjellim në vëmendje qëndrimet<sup>9</sup> që ka mbajtur Kolegji në çështje të ndryshme, sipas të cilave, megjithëse nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka*

---

<sup>7</sup> Neni 601 i Kodit Civil parashikon: “Kapari quhet shuma në të holla që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do t'i paguhet në bazë të kontratës, me qëllim që të vërtetojë lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj”.

<sup>8</sup> Neni 602 i Kodit Civil parashikon: “Kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka dhënë kapar, kjo palë e humbet kaparin; kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka marrë kaparin, kjo palë është e detyruar të kthejë dyfishin e kaparit. Pala që ka faj për mosekzekutimin e kontratës është e detyruar t'i shpërblejë palës tjetër edhe dëmin, duke llogaritur në shpërblimin e këtij dëmi dhe shumën e kaparit, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe”.

<sup>9</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018 (JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; vendimi nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2; vendimi nr. 23/2020 (JR), datë 25.09.2020, paragrafi 26.2; vendimi nr. 11/2021 (JR), datë 31.03.2021, paragrafi 26.2.

të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se u vlerësua në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve të dhëna në to me provat e tjera dhe çdo të dhëne apo informacioni të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ.

**24.7** Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, nuk gjendet asnjë gjurmë në formën e një fature ose mandati bankar, qoftë edhe deklaratë noteriale në kohë reale, që të vërtetojë kthimin e këtij kapari te znj. V. Nuk rezulton në asnjë dokument se situata financiare është kthyer në gjendjen para hartimit të kontratës së kaparit dhe nuk ka dokument justifikues për të provuar likuidimin e palëve përkatëse dhe kthimin në gjendjen e mëparshme (kthimin e shumës prej 1.500.000 lekësh). Për revokimin e kësaj kontrate nevojitej të parashikohej dhe të pranohej nga palët në rrugë juridiko-formale, çka nënkupton se kjo marrëdhënie tashmë e ndërprerë nuk është dokumentuar në asnjë dokument dhe, si e tillë, nuk është provuar që është kthyer në gjendjen e mëparshme, ndaj i gjithë pretendimi i subjektit të rivlerësimit ka mbetur në nivel deklarativ. Vetë kushtet e kontratës së hartuar nëpërmjet neneve që janë parashikuar në të për t'u zbatuar, sjellin sanksione për palët në rast të moszbatimit të parashikimeve të dakordësuara nga vetë ata. Përfshirja e nenit 602 të Kodit Civil në këtë kontratë, parashikon penalizime për të dyja palët në rast të mospërmbushjes së detyrimeve që lindin prej saj. Konkretisht, pala kapardhënëse e humbet shumën e dhënë kapar nëse nuk përmbushen kushtet e kontratës, ndërsa pala kaparmarrëse detyrohet të kthejë dyfishin e shumës së marrë kapar nëse nuk respektohen kushtet e kontratës së dakordësuar prej tyre. Që një penaltet i tillë të mos ekzekutohej për palët kontraktore, nevojitej dokumentimi në rast të prishjes së marrëveshjes dhe qenies para një zgjidhjeje tjetër, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, për kthimin e shumës së dhënë kapar, nënës së tij.

**24.8** Sa më sipër analizuar, Kolegji vlerëson se, për shkak të mungesës së dokumentacionit provues, nuk del e qartë nëse kapari është kthyer dhe subjekti i rivlerësimit ka shtuar vetëm vlerën 400.000 lekë, apo kapari nuk është kthyer nga z. H dhe subjekti i rivlerësimit ka shtuar shumën 1.900.000 lekë, të cilën e ka parashikuar në kontratën e blerjes së apartamentit. Nga ana tjetër, faktet dhe provat tregojnë se vetë shitësi, z. H, një apartament të cilin e ka vlerësuar 4.500.000 lekë (sipas kontratës së kaparit) për t'ia shitur në datën 30.05.2000 nënës së subjektit, ia shet dy muaj më vonë më pak se gjysmën e çmimit të dakordësuar në kontratën e kaparit, subjektit të rivlerësimit, në vlerën 1.900.000 lekë (sipas kontratës së shitjes ndërmjet tij dhe subjektit të rivlerësimit), duke e bërë kështu jobindës pretendimin në lidhje me çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes. Në Kolegji krye analiza ekonomike alternative, nëse vlera e kaparit të paguar nga nëna e subjektit të rivlerësimit do të konsiderohej si e kthyer nga shitësi, z. H. Në këto kushte, vlera e pasurisë së blerë nga subjekti i rivlerësimit nuk do të mund të konsiderohej më në vlerën 1.900.000 lekë, por tashmë në vlerën 4.500.000 lekë. Nga analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve, edhe sikur shuma e kaparit të konsiderohej e kthyer, përsëri subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me një diferencë negative në vlerën 4.166.485 lekë. Si rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për kthimin e kaparit nënës së tij, nuk u provua, mbeti në nivel deklarativ dhe, si i tillë, shkak i ankimit nuk gjendet i bazuar.

**24.9** Kolegji konstaton se burim tjetër që afekton blerjen e apartamentit 157 m<sup>2</sup>, sipas subjektit të rivlerësimit, është vlera e shitjes së apartamentit të prenotuar me kontratë kapari nga nëna e tij, të cilin sipas dokumentacionit të administruar në dosje, rezultoi se e ka shitur më datë 05.03.2004, me kontratën e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., me vlerën 1.900.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 2 në Komision, se shitja e apartamentit z. M. R, *de facto* ka ndodhur që në vitin 2002, por kontrata u finalizua më datë 05.03.2004, pasi në këtë moment z. R. pagoi vlerën e mbetur pa paguar, prej 200.000 lekësh. Për të provuar këtë fakt,

subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë në Komision deklaratën noteriale me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 04.12.2014, nga shtetasi M. R. Për këtë provë, sjellim në vëmendje qëndrimet e Kolegjit për deklaratat noteriale, të cilat vlerësohen në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve të dhëna në to me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ.

**24.10** Kolegji vëren se, nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, konstatohen mandatat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për pagesat e kryera në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK (të cituar edhe në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie). Nga verifikimi i këtyre mandateve, rezulton se pagesa e plotë në shumën prej 6.000.000 lekësh, në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, është kryer deri më datë 10.07.2003. Si rrjedhojë, periudha e shitjes së apartamentit zotit R. nuk përkon me blerjen e apartamentit 157 m<sup>2</sup>, pasi rezulton të jetë shitur më vonë (në vitin 2004), ndaj të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë shtetasit M.R. (në vlerën 1.900.000 lekë), nuk mund të kenë shërbyer për kryerjen e pagesave (2002-2003) në favor të shoqërisë “{\*\*\*}”, si rrjedhojë nuk mund të merren në konsideratë dhe të përlllogariten si burim krijimi i pasurisë apartament banimi me sip. 157 m<sup>2</sup>, pasi, referuar dokumentacionit ligjor, shitja e apartamentit z. R. ka ndodhur më datë 05.03.2004. Në dokumentacionin e administruar në dosje, nuk gjendet asnjë provë që vërteton se pagesat janë kryer në vitin 2003. Për këtë arsye, vlera e së ardhurës nga kjo pasuri u konsiderua e përfituar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2004, bazuar edhe në kontratën e shitblerjes së apartamentit. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit që t’i llogariten të ardhurat nga shitja e apartamentit prej 1.900.000 lekësh, si burim krijimi i apartamentit të blerë 6.000.000 lekë, nuk gjendet i bazuar.

25. Subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se konkluzioni i arritur nga Komisioni për konvertimin e vlerës 31.143 USD nga të ardhurat nga shitja e pasurisë së nënës, të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, nuk është i drejtë, pasi Komisioni duhej të konvertonte vlerën 31.143 USD me kursin mesatar të muajit qershor 1997, sipas Bankës së Shqipërisë ku 1 USD = 179,06 lekë, kurs sipas të cilit vlera e konvertuar do të rezultonte 938.338 lekë më shumë se e Komisionit, i cili e ka konvertuar shumën në dollarë me kursin 1 USD = 148,93 lekë. Sipas subjektit të rivlerësimit, vlerat e përfituara nga nëna e tij nga shitja e pasurive në Gjirokastrë, janë marrë në dy këste, jo në tri, siç është parashikuar në kontratë dhe këto vlera janë marrë *cash*. Kësti i parë është marrë në datën 13.11.1996, ndërsa kësti tjetër është marrë në maj të vitit 1997. Sipas subjektit të rivlerësimit, vetëm vlera prej 26.000 USD është depozituar në bankë, ndërsa pjesa tjetër është konvertuar në tregun e lirë në qershor të vitit 1997, me kursin 1 USD = 180 lekë.

**25.1** Kolegji konstatoi se në datën 31.12.2003, subjekti i rivlerësimit dispononte këto pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme: (1) pasurinë e llojit apartament, blerë në vitin 2000, me çmimin 1.900.000 lekë; (2) pasurinë e llojit apartament, porositur nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me çmimin 6.000.000 lekë; (3) depozitë në vlerën prej 26.000 USD; (4) automjet me vlerë 300.000 lekë; dhe (5) depozitë në emër të bashkëshortes, në shumën prej 1.000.000 lekësh.

**25.2** Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, u përlllogaritën të gjitha veprimet për të konvertuar vlerën e përfituar nga nëna e subjektit të rivlerësimit. Nga publikimi i kurseve historike të Bankës së Shqipërisë, rezulton se kursi mesatar i USD për vitin 1997, ka qenë 1 USD = 148,93 lekë. Kursi mesatar i muajit qershor 1997, ka qenë 1 USD = 179,069 lekë. Kursi mesatar i periudhës qershor-dhjetor 1997, ka qenë 1 USD = 156,668 lekë. Subjekti i rivlerësimit, në analizën e paraqitur në Komision dhe Kolegji, ka konvertuar vlerën 31.143 USD me kursin mesatar të muajit qershor 1997. Nga analiza e kryer në Kolegji, sipas të dhënave të mësipërme, rezulton se edhe nëse do të

konsideroheshin pretendimet e subjektit për konvertimin e shumës së nënës me kursin mesatar të muajit qershor 1997, përsëri subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të përballonte krijimin e pasurisë apartament banimi me sip. 157 m<sup>2</sup>. Saktësisht, diferenca negative e rezultuar në Komision për analizën financiare të periudhës 1994-2003, ka rezultuar në vlerën -4.566.485 lekë, gjithashtu në analizën e kryer në Kolegj me kursin mesatar të vitit 1997, diferenca negative për analizën financiare të periudhës 1994-2003, rezulton e njëjtë me atë në Komision.

Sa më sipër, shkaku i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit lidhur me përlllogaritjen e kursit të dollarit amerikan me një vlerë tjetër, përlllogaritja e të cilit do të rezultonte me 938.338 lekë më shumë se përlllogaritja e Komisionit, nuk gjendet i bazuar.

26. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se shpenzimet e mobilimit të deklaruar nga ai në pyetësorët e Komisionit, në vlerën 700.000 lekë, nuk mund të konsiderohen si një shpenzim i ndarë nga shpenzimet e jetesës sepse janë pjesë e tyre. Subjekti pretendon që shpenzimet e mobilimit të konsiderohen 0 (zero) dhe në analizën që ka paraqitur, nuk i ka vendosur këto shpenzime.

26.1 Kolegji vëren se në analizën e kryer nga Komisioni, në shpenzimet e jetesës, grupi i konsumit “mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës” zënë afro 6% të strukturës së shpenzimeve totale. Komisioni, në përlllogaritjen e tij, vlerës së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit i ka zbritur 6% sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit dhe nga përlllogaritja sipas kësaj metode, shpenzimet e jetesës i kanë rezultuar në vlerën 552.474 lekë. Nëse do të konsiderohej ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, atëherë nga përlllogaritja do të rezultonte se shpenzimet e deklaruara nga ai për shpenzime dhe mobilim do të zinin rreth 28% të shpenzimeve të jetesës. Në analizën e kryer në Kolegj, janë vendosur shpenzimet e mobilimit dhe shpenzimet e jetesës sipas analizës së kryer në Komision, duke qenë se subjekti i rivlerësimit i ka pranuar këto shpenzime duke i kryer edhe përlllogaritjet përkatëse të këtyre viteve, duke përdorur këto shpenzime jetese për referencë. Sa më sipër, shkaku i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.

27. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se është provuar në mënyrë të plotë se A.M, nëna e bashkëshortes së subjektit, ka pasur burime të ligjshme për krijimin e vlerës 1.000.000 lekë, të cilat ia ka dhuruar vajzës së saj M.V, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ndaj konkluzioni i Komisionit për mospërfshirjen e kësaj shume si përfitim nga shitja e pasurisë së trashëguar, është i pabazuar në prova dhe në ligj. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është provuar se çmimi 500.000 lekë i shitjes së pasurisë së ndodhur në lagjen “{\*\*\*}” të qytetit të Elbasanit nga trashëgimtarët e V. H te B.G është joreal në raport me përmbajtjen e deklaratës noteriale të këtij të fundit dhe çmimit të referencës së shitjes së pasurive të paluajtshme për qytetin e Elbasanit, pasuri e cila është shitur në vlerën 4.800.000 lekë.

27.1 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka krijuar një depozitë në Tirana Bank në shumën 1.000.000 lekë, më datë 31.12.2003.

Në deklaratën e para fillimit të detyrës në vitin 2003, kjo depozitë është deklaruar me përshkrimin: “Të ardhura nga prindërit e bashkëshortes si pjesë e trashëgimisë”.

Në deklaratën *vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka përshkruar këtë depozitë: *Unë disponoj në Bankën e Tiranës vlerën 6.200.000 lekë. Kjo depozitë është krijuar në 30 dhjetor 2003, në shumën e derdhur prej 1.000.000 lekësh, e krijuar nga kursimet familjare.*

Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion për të provuar se të ardhurat për të krijuar këtë pasuri kanë qenë sipas specifikimeve në deklaratën e parë të pasurisë.

**27.2** Lidhur me mospërputhjet e mësipërme, Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit në pyetësorin nr. 3, i cili është përgjigjur se: *Ky dhurim i është dhënë cash bashkëshortes sime nga nëna e saj. Burimi i krijimit të vlerave cash të prindërve së bashkëshortes sime ka ardhur nga shitja e një dyqani në Korçë, pronë e babait të bashkëshortes, shitur ky rreth viteve 94-95, nuk e di me siguri, por nga shitja u përfituan rreth 800.000 lekë, pasuri e cila ishte në emër të babait dhe xhaxhait të bashkëshortes, por në rrethanat kur kanë kaluar 25 vjet dhe kur të dy pronarët e pasurisë kanë ndërruar jetë, nuk mund të gjej prova për t'ju paraqitur, pasi nuk di nr. e pasurisë së shitur dhe personat blerës, në mënyrë që ZRVPP Korçë, të shohë transformimin e pronës.*

**27.3** Kolegji konstaton se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi se në datën 09.02.2004 është shitur një ndërtesë dykatëshe në vlerën 500.000 lekë, në pronësi të nënës së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo nuk ka qenë vlere e saktë e shitjes së kësaj pasurie dhe, për të provuar këtë, ai ka sjellë deklaratën noteriale me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 02.10.2019, nga blerësi B.G, i cili deklaroi se e ka blerë këtë pasuri me çmimin 4.800.000 lekë dhe jo 500.000 lekë, siç parashikohet në kontratën e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 09.02.2004. Për këtë dokument të sjellë nga subjekti i rivlerësimit, sjellim në vëmendje qëndrimet e Kolegjit për deklaratat noteriale, të cilat vlerësohen në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve të dhëna në to, me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ. Në dosjen e hetimit administrativ, nuk gjendet asnjë dokumentacion për të provuar këtë vlerë të shitjes. Edhe sikur pretendimi i subjektit të rivlerësimit të ishte i saktë lidhur me çmimin e shitblerjes së kësaj pasurie, kontrata daton më 09.02.2004, ndërsa depozita në Tirana Bank është krijuar në datën 31.12.2003, pra dy muaj përpara se të përfitoheshin të ardhurat nga shitja e ndërtesës.

**27.4** Subjekti i rivlerësimit pretendon edhe burime të tjera për krijimin e pasurisë së prindërve të bashkëshortes, për të cilat në dosjen e administruar nga Komisioni, nuk rezultoi asnjë dokumentacion në lidhje me letrat me vlerë, qiratë e përfituara nga babai i bashkëshortes së subjektit apo të ardhura të përfituara nga statusi i të përndjekurit politik për të vërtetuar të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit. Sa më sipër, nuk rezultoi i provuar burimi i ligjshëm i pasurisë si dhurim nga prindërit e bashkëshortes, si rrjedhojë ky shkak ankimi nuk gjendet i bazuar.

**27.5** Nga sa u analizua më sipër, lidhur me shkaqet e ankimit të pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 157 m<sup>2</sup>, rezultoi se nuk u provuan burimet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit gjatë këtij procesi si dhe në deklaratat e pasurisë, pasi apartamenti i prenotuar nëpërmjet kaparit nga nëna e tij, të cilin më pas e ka blerë subjekti i rivlerësimit, është shitur më vonë (2004) se është blerë (2002) apartamenti me sipërfaqe 157 m<sup>2</sup>, ndaj nuk mund të shërbenin të ardhurat nga shitja si burim i blerjes së apartamentit objekt shqyrtimi. Nga ana tjetër, duke qenë se në dokumentacionin e administruar në dosje nuk rezultoi asnjë dokument i cili të vërtetonte kthimin e shumës së kaparit të nënës së subjektit të rivlerësimit dhe kthimin e palëve në gjendjen fillestare, kjo shumë nuk u konsiderua në analizën financiare në Kolegj. Edhe sikur vlere e kaparit të konsiderohet e kthyer dhe çmimi i apartamentit të konsiderohet 4.500.000 lekë, përsëri subjekti do të gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë të burimeve për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 4.166.485 lekë. Si rrjedhojë e analizës për këtë shkak ankimi, rezultoi se subjekti i rivlerësimit për



periudhën 1994 – 2003, ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar pasurinë me burime të ligjshme, në vlerën 4.566.485 lekë, si rrjedhojë ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

28. Lidhur me pasurinë autoveturë tip Benz Mercedes, me targë {\*\*\*}, të blerë me vlerë 12.000 USD sipas kontratës me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.10.2016, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se nuk ka pasur shoqëri apo nuk ka gjykuar asnjë çështje penale apo civile të ngritura prej P.Ç apo ndaj tij. Për këto arsye, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ekziston asnjë lloj dyshimi që të ketë përdorur këto lidhje për përcaktimin e çmimit të këtij sendi. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky mjet nuk është zhdoganuar prej tij dhe se ai nuk ka pasur dijeni për mënyrën e krijimit të kësaj pasurie nga P. Ç. Subjekti i rivlerësimit pretendon se transaksioni për blerjen e kësaj pasurie është kryer me anë të bankës, duke qenë se e kalonte vlerën 1.000.000 lekë.

**28.1** Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Komisioni ngre dyshime të arsyeshme se tërësia e transaksioneve të kryera deri në blerjen përfundimtare të këtij automjeti nga subjekti, duket se janë bërë me qëllim për të fshehur vlerën reale të blerjes së tij, si rrjedhojë, ekzistojnë dyshime të arsyeshme se kontrata e nënshkruar nga subjekti për shitblerjen e kësaj pasurie, është fiktive. Me dërgimin e prapësimeve, z. Arben Vrioni nuk arriti të japë shpjegime dhe prova bindëse për të rrëzuar dyshimet e ngritura nga trupi gjykses.*

**28.2** Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë: *Autoveturë tip Mercedes Benz, vit prodhimi 2010, me targa {\*\*\*}, blerë në vlerën 12.000 USD, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.10.2016. Burimi i vlerës së blerjes së këtij mjete është nga depozita në dollarë në B.K. Tregtare në emrin e nënës sime dhe në emrin tim, e krijuar në vitin 2000, pas tërheqjes dhe mbylljes së depozitës në vlerën 26.000 USD në BIA (Banca Italo-Albanese, depozitë e krijuar më datë 09.06.1997).*

**28.3** Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Autoveturë tip Mercedes Benz, vit prodhimi 2010, me targa {\*\*\*}, blerë në vlerën 12.000 USD, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*}kol., datë 10.10.2016, kjo vlerë është tërhequr nga depozita në B.K.T.*

**28.4** Kolegji konstaton se nga hetimi administrativ, rezultoi se DPSHTRR-ja, me shkresat me nr. {\*\*\*}, datë 30.01.2019 dhe nr. {\*\*\*}, datë 06.02.2019, konfirmon se në emrin e subjektit të rivlerësimit figuron i regjistruar automjeti me targë {\*\*\*}, duke dërguar dhe dosjen e plotë të këtij mjete. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni, ka rezultuar se në datën 05.05.2016, ky automjet është blerë nga shtetasi A.D në Gjermani, për shumën prej 16.500 eurosh. Më datë 09.05.2016, është kryer zhdoganimi i këtij mjete, me vlerë të detyrimit doganor të paguar prej 460.000 lekësh. Pas zhdoganimit, vlera në total e këtij mjete vlerësohet rreth 2.750.000 lekë (pa llogaritur transportin nga vendi i origjinës dhe as detyrimet e paguara për regjistrimin dhe targimin e tij). Më datë 11.05.2016, shtetasi A.D ia shtet këtë automjet shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në vlerën prej 900.000 lekësh. Në kontratë citohet se *motori makinës nuk është në gjendje pune dhe se shitësi nuk merr përsipër pasojat që mund të rrjedhin nga ky defekt teknik në të ardhmen.* Në datën 10.05.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka tërhequr *cash* 20.000 USD, nga llogaria e tij në BKT, një ditë para shitjes së këtij mjete shoqërisë “{\*\*\*}”. Më datë 12.05.2016, shoqëria “{\*\*\*}” ka kryer kontrollin fizik të këtij mjete dhe e ka regjistruar në emrin e vet, megjithëse sipas kontratës së shitjes së një dite më parë, mjete nuk ishte në gjendje pune. Më datë 10.10.2016, subjekti i rivlerësimit ia blen këtë automjet shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në vlerën 12.000 euro, të cilin më datë

13.10.2016, e ka regjistruar mjetin në emrin e tij, duke kryer kontrollin fizik të mjetit, si dhe duke deklaruar: *humbje, vjedhje, dëmtim targe*. Më pas, janë ndërruar targat nga {\*\*\*}, në {\*\*\*}.

**28.5** Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit në lidhje me shumën e tërhequr *cash* (20.000 USD) se për çfarë destinacioni e ka përdorur, i cili, në përgjigje të këtij pyetësi, është shprehur se: *Kjo shumë u tërhoq për blerjen e një automjeti, pasi unë u emërova gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës, pasi m'u paraqit një variant për blerje, vendosa ta marr me para në dorë, ndaj dhe tërhoqa para në bankë dhe meqë ky variant nuk u realizua, gjeta këtë makinë që kam dhe sot, në vlerën 12.000 \$, blerë nga subjekti "{\*\*\*}" ShPK, transfera e të cilave u bë nëpërmjet bankës, duke i rifitur 12.000 \$, ndërsa 8.000 \$ për t'i përdorur për diçka tjetër.*

**28.6** Nga dokumentacioni i administruar në dosje, Kolegjit i rezultoi se nga të dhënat bankare të subjektit të rivlerësimit, në Bankën Kombëtare Tregtare është kryer një tërheqje nga subjekti i rivlerësimit në shumën 20.000 USD në datën 10.05.2016. Në datën 11.10.2016, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në të njëjtën llogari bankare shumën prej 12.024 USD dhe në përshkrimin e veprimit bankar, është shënuar se burimi i të ardhurave ka qenë "Shitje poliklinike". Në të njëjtën datë, subjekti i rivlerësimit ka kryer një transfertë nga kjo llogari në shumën 12.000 USD në favor të "{\*\*\*}" ShPK, me përshkrimin "Likuidim për blerje autoveture". Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer transaksionin e transferimit për likuidimin e vlerës së blerjes së automjetit në datën 11.10.2016, një ditë pas lidhjes së kontratës së shitblerjes së këtij automjeti.

**28.7** Kolegjit, në përfundim të analizës për pasurinë automjet tip Benz Mercedes, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë automjet gjashtë vite pas prodhimit të tij në vlerën 12.000 USD, në një kohë që ky mjet ishte blerë në Gjermani në vlerën 16.500 euro (gati 2-fishi i çmimit të blerjes së tij nga subjekti) pesë muaj para se ta blinte subjekti i rivlerësimit. Transaksionet lidhur me këtë automjet, nuk është e qartë nëse janë kryer për të ulur çmimin e deklaruar në blerjen fillestare (16.500 euro) të këtij automjeti, pasi shoqëria "{\*\*\*}" ShPK e blen me çmimin 900.000 lekë, pak ditë pasi makina ka dalë nga koncesionari gjerman, duke deklaruar në kontratën e blerjes se motori i mjetit nuk është në gjendje pune, më pas pesë muaj më vonë ia shet subjektit të rivlerësimit me çmimin 12.000 USD. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision vërtetime<sup>10</sup> nga Gjykata e Apelit Durrës, si dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, nëpërmjet të cilëve provon se ai nuk ka gjykuar çështje me palë ndërgjyqëse, ndër të tjerë, edhe P.Ç dhe "{\*\*\*}" ShPK. Në lidhje me shitblerjen e kësaj pasurie, rezulton i paqartë me variacion të dukshëm çmimi i saj nga kontrata në kontratë. Nga ana tjetër, nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit, rezultoi se kishte disponibilitet financiar për të blerë automjetin, i cili vërtetohet me tërheqjen prej 20.000 USD nga llogaria e tij bankare, si rrjedhojë kjo e bën të besueshëm faktin që subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin me çmimin e referuar në kontratën e shitblerjes.

**28.8** Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie sipas çmimit të përcaktuar në kontratën e shitblerjes. Sa më sipër, konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri nuk është i bazuar në një hetim të thelluar për të arritur në përfundimin se çmimi i blerjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit, është më i lartë se ai i deklaruar në kontratën e shitblerjes, si rrjedhojë nga analiza e shkakut të ankimit të mësipërm, nuk mund konkludohet se gjendemi në ndonjë prej rasteve sipas

---

<sup>10</sup> Vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. {\*\*\*} akti, datë 02.10.2019; vërtetim nga Gjykata e Apelit Durrës, nr. {\*\*\*} prot., datë 27.09.2019

parashikimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ndaj në këto kushte, këto rrethana faktike nuk mund të ngrihen në nivelin e një shkaku shkarkimi.

29. Lidhur me transfertat e kryera nga nëna e subjektit të rivlerësimit në favor të shtetasit B. D, subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimet e Komisionit, duke shpjeguar se vlera e transferuar nga nëna e subjektit, në shumën prej 35.000 USD, nuk ka të bëjë me vlerën 25.000 GBP që kunati i tij i ka dërguar për shkollimin e vajzës. Vlera 35.000 USD është vlerë që ka sjellë shtetasi B.D dhe familjarët e tij në Shqipëri, e përfituar nga shitja e një shtëpie në pronësi të tyre. Kjo shumë, sipas subjektit të rivlerësimit, është mbajtur nga nëna e bashkëshortes së tij, znj. A.M, dhe z. B.D. Sipas subjektit, në dokumentacionin bankar të transfertës, në rubrikën detaje të pagesës, është shënimi “Personal Trasfer” dhe kjo e qartëson në këtë mënyrë dyshimin e ngritur nga Komisioni.

**29.1** Konkluzionet e Komisionit për këtë rrethanë faktike: *Trupi gjykues ngre dyshime të arsyeshme se vlera prej 35.000 USD, transferuar nga nëna e subjektit të rivlerësimit në favor të z. B.D., përfaqëson vlerën monetare që subjekti ka transferuar në favor të tij me qëllim kthimin mbrapsht të shumës prej 25.000 GBP, të transferuara nga z. B.D., 12 ditë më parë, në llogari të vajzës së subjektit - si rrjedhim, duket se subjekti ka deklaruar një marrëdhënie fiktive huaje, me qëllim mbulimin e të ardhurave të pajustifikuara që kanë shërbyer për shkollimin e vajzës së tij. [...] Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e dërguara, por edhe gjatë seancës dëgjimore dha shpjegimet e tij lidhur me këtë transfertë të kryer nga nëna e tij, si dhe mënyrën e transferimit të kësaj shume nga shtetasi B.D., në shtetin shqiptar. Trupi gjykues, pasi analizoi prapësimet e subjektit dhe deklarimet e tij gjatë seancës dëgjimore, vlerëson se z. Arben Vrioni nuk arriti të japë shpjegime bindëse të bazuara në dokumentacion ligjor provues, për të rrëzuar dyshimet e ngritura.*

**29.2** Në deklaratën *vetting*, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Në vitin 2009, vajza e tij, znj. I.V, u pranua të kryejë studimet në {\*\*\*}, kundrejt një shume prej 43.000 GBP. Një pjesë të kësaj shume, në vlerën 25.000 GBP, të barabartë me 42.000 USD, ia ofroi baxhanaku im, z. B.D, i cili jeton në Amerikë prej vitit 1990. Kjo hua na u dha pa interes dhe pa afat shlyerje dhe është marrë me transfertë bankare, nëpërmjet “Alpha Bank”, në datën 06.08.2009. Këtë shumë të marrë hua prej tij fillova ta shlyej si më poshtë: Në vitin 2015 kam shlyer bashkë me vajzën time I. vlerën 15.000 USD, nga të cilat 10.000 USD të shlyera nga unë nga të ardhurat tona (të cilat i kam pasur në lekë e të tërhequra nga llogaria e pagës në “Raiffeisen Bank” në muajt e fundit të vitit 2014) dhe vlera 5.000 USD nga I., e ardhur e krijuar nga puna e saj. Në vitin 2016 kam shlyer vlerën 10.000 USD, nga të cilat 5.000 USD unë dhe 5.000 USD I.*

**29.3** Nga dokumentacioni i administruar në dosje, Kolegjit i rezultoi se në datën 05.08.2009, shtetasi B.D (baxhanaku i subjektit) ka transferuar në llogarinë bankare të vajzës së subjektit në Alpha Bank, shumën 25.000 paund, të deklaruar nga ana e subjektit në DIPP-në e vitit 2009 si hua e dhënë për shkollimin e vajzës së tij. Nga dokumentacioni bankar i administruar në dosjen e Komisionit gjatë hetimit, referuar të dhënave të dërguara nga OTP Bank, rezultoi se 12 ditë pas kësaj transferte, nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. H.V, në datën 17.08.2009, ka hapur llogari në USD në këtë bankë, duke depozituar *cash* shumën prej 35.000 USD, dhe po në të njëjtën datë këtë shumë e transferon për llogari të shtetasit B.D.

**29.4** Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit në pyetësorin nr. 2, se cili ka qenë burimi i të ardhurave të shtetasit B.D që mundësoi huan e dhënë, në përgjigje të të cilit subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se baxhanaku i tij, burimin e të ardhurave e ka fituar nga kompania e sigurimeve, për shkak të një aksidenti që i kishte ndodhur në vendin e punës.

**29.5** Meqenëse kjo është një hua e deklaruar e subjektit të rivlerësimit, referuar nenit 3, pika 14, si dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, z. B.D bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Si rrjedhojë, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të z. B.D, për të verifikuar mundësinë e krijimit të shumës së dhënë hua subjektit të rivlerësimit për shkollimin e vajzës së tij.

**29.6** Subjekti i rivlerësimit, me prapësimet për rezultatet e hetimit, me qëllim vërtetimin e burimit të të ardhurave të z. D, depozitoi në Komision dokumentacion në gjuhën angleze (me vulë apostile dhe i përkthyer në shqip e noterizuar), nga një kompani sigurimi, sipas të cilit z. D. është dëmtshpërblyer si pasojë e një aksidenti në ambientin e punës, prej të cilit ai kishte mbetur i lënduar. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar prej subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka konkluduar se z. B.D ka disponuar të ardhura të mjaftueshme, të krijuara nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht shumën e dhënë hua në favor të subjektit të rivlerësimit.

**29.7** Kolegji vëren se në dokumentacionin e administruar në dosje, rezultoi urdhri i transfertës së Bankës Popullore, dega Elbasan, me klient urdhërues H.V dhe me klient përfitues B.D. Shuma e transferuar është 35.000 USD dhe data e ekzekutimit të transfertës është 17.08.2009. Në shpjegimet që subjekti i rivlerësimit ka dhënë mbi këtë transfertë, sqarohet se kjo ka qenë një transfertë personale e nënës së tij, e cila e kishte kryer atë me kërkesë të vjehrrës së tij. Vjehrra e subjektit të rivlerësimit nuk ishte në gjendje të mirë shëndetësore dhe i duhej të transferonte në llogari të tyre shumën të cilën i kishin lënë z. D. dhe vajza e saj për një investim të mundshëm, i cili nuk ndodhi.

**29.8** Në dokumentacionin e administruar në Komision, gjenden dy deklarata noteriale të cilat i ka lëshuar baxhanaku i subjektit të rivlerësimit, z. B.D. Në deklaratën me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 13.11.2014, deklarohet se z. D. i ka kaluar shumën 25.000 GBP vajzës së subjektit të rivlerësimit kundrejt asnjë interesi për shkollimin e saj. Këtë shumë ai ia ka dhënë sepse marrëdhëniet e tyre familjare kanë qenë të afërta. Në deklaratën me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 21.09.2019, z. D. deklaroi se 10.000 USD i janë kthyer *cash* nga vajza e subjektit të rivlerësimit, I.V, në vitin 2015 dhe në vitin 2016 subjekti i rivlerësimit i ka kthyer *cash* z. D. shumën 5.000 USD, gjatë periudhës së qëndrimit të tij në Shqipëri, ndërsa shuma prej 10.000 USD i është dhënë bashkëshortes së z. D. *cash*, në vitin 2015, gjatë kohës që ajo ishte në Shqipëri.

**29.9** Lidhur me transfertën e kryer nga nëna e subjektit të rivlerësimit në llogarinë e B.D, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për këtë fakt, i cili ndër të tjera deklaroi se: *[...] baxhanaku i tij, z. B.D, dispononte një shumë parash në Shqipëri, të cilën kishte dëshirë ta investonte për blerjen e një banese, pasi atë që dispononte më parë, e kishte shitur. Meqenëse pas një kohe të gjatë, nuk pëlqeu asnjë nga variantet për blerje banese, pasi nuk ishin me parametrat e kërkuara nga ana e tij, shuma iu kthye nëpërmjet transfertës bankare, të bërë nga nëna e tij [...].* Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se transfertat mban përshtetshmëri dhe nuk ka lidhje me shumën 25.000 GBP, nuk qëndron në këtë rast, pasi ky koment vendoset si përshtetshmëri nga personeli i bankave në ekzekutimin e transfertave individuale, kur klientët nuk kanë një përshtetshmëri shtesë dhe të detajuar për të dhënë.

**29.10** Në përfundim të analizës së shkakut të ankimit, Kolegjit i rezultoi i provuar fakti se z. B.D kishte mundësi për të dhënë hua për shkollimin e vajzës së subjektit të rivlerësimit, nga ana tjetër mbeti e paprovuar nëse këto para i janë kthyer huadhënësit pasi nuk ka transfertat bankare apo dokumentacion tjetër justifikues, përveç deklaratës noteriale të këtij të fundit, e cila është hartuar

gjatë procesit të rivlerësimit. Gjithashtu në nivel deklarativ mbeti edhe fakti i transfertës bankare prej 35.000 USD të nënës së subjektit të rivlerësimit, drejt llogarisë bankare të z. B. D, nëse kjo vlerë monetare ishte me të vërtetë e këtij të fundit, pasi nuk ka gjurmë si është transferuar prej tij në Shqipëri dhe, nëse vërtet ka dashur të investojë shumën të cilën ia ka lënë nënës së tij, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Gjithsesi, për Kolegjin, rrethanat e cituara më sipër, nuk mund të konsiderohen se janë të mjaftueshme për të konkluduar se gjendemi në ndonjë prej parashikimeve ligjore të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe, sipas këtij parashikimi ligjor, nuk janë kualifikuar as nga Komisioni, ndaj në këto kushte nuk mund të ngrihen në nivelin e një shkaku shkarkimi.

30. *Lidhur me analizën financiare për vitet 2005, 2007 dhe 2009*, subjekti i rivlerësimit përkatësisht për vitin 2005, ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit është i njëanshëm në interpretimin e provave, nuk është proporcional dhe është interpretim i gabuar i ligjit. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni në mënyrë të njëanshme ka hequr nga analiza financiare e vitit 2005, vlerën prej 500.000 lekësh, të krijuar si kursim *cash* të deklaruar në vitin 2004, kursim ky i deklaruar në deklaratën periodike vjetore që i përket periudhës së vitit 2005, me arsyetimin se vlera nuk është deklaruar *cash* në fund të vitit 2004 nga subjekti i rivlerësimit. Sipas tij, Komisioni nuk e ka pasqyruar në analizën e tij vitin 2004, me qëllimin e vetëm për ta penalizuar, duke qenë se do të rezultonte me një diferencë negative. Sipas subjektit, diferenca pozitive në vitin 2005 do të ishte në vlerën 610.587 lekë. Lidhur me vitin 2009, subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka hequr në mënyrë të njëanshme nga analiza financiare, vlerën 600.000 lekë, të krijuar si kursim nga subjekti në vitin 2008. Në analizën që subjekti ka paraqitur në ankimin e tij për vitin 2008, ai rezulton me një diferencë pozitive, në vlerën 288.381 lekë.

**30.1** Konkluzionet e Komisionit për këtë analizë financiare: *Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera për vitin 2005. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara/të shtuara (likuiditetet) dhe shpenzimet e kryera për vitin 2009.*

**30.2** Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2005, subjekti ka deklaruar: (i) vlerën prej 1.000.000 lekësh shtesë në llogarinë bankare të bashkëshortes së tij në Tirana Bank; dhe (ii) këmbimin e automjetit, duke deklaruar shtesë pagese prej tij në vlerën 50.000 lekë. Referuar deklaratës fillestare të pasurisë, si dhe deklaratës periodike vjetore të vitit 2004, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shumën të kursyer *cash* në banesë. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në vitin 2004, ka kursyer vlerën 500.000 lekë, dhe se kjo vlerë ka shërbyer për krijimin e shtesës së llogarisë depozitë, në vlerën 1.000.000 lekë, të depozituar në Tirana Bank.

**30.3** Në analizën financiare të kryer në Kolegj, nuk janë marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit për kursime në banesë në vitin 2004, në shumën 500.000 lekë, meqenëse kjo shumë nuk është deklaruar nga ai në deklaratën periodike të vitit 2004. Lidhur me këtë mosdeklarim, subjekti i rivlerësimit nuk identifikoi arsye bindëse përse nuk ka deklaruar kursimet *cash*, duke iu referuar edhe gjendjes familjare të këtij viti, ku vetë ka qenë kryefamiljar dhe potencialisht në kushte të favorshme për të ditur dhe identifikuar sasinë e gjendjes së *cash*-it të kursyer në banesë, i cili do të ishte objekt deklarimi në vitin përkatës. Si përfundim, në vlerësim të dokumentacionit të administruar në dosje, deklarimeve të dhëna dhe provave të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe të personave të lidhur, analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2005 rezultoi me një diferencë negative në

vlerën 631.151 lekë, dhe subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk mund të përballonte krijimin e kursimeve dhe shpenzimet për këtë vit.

**30.4** Lidhur me analizën financiare për vitin 2007, Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash*, ndërsa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 deklaroi kursime të dy viteve, në vlerën 1.200.000 lekë (të cilat janë deklaruar si burim i shtesës prej 1.200.000 lekësh në llogarinë depozitë të bashkëshortes së subjektit në Tirana Bank, në vitin 2007). Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, i pyetur nga Komisioni, ka deklaruar se: *[...] nuk është në gjendje të përcaktojë me saktësi gjendjen cash të disponuar në fund të vitit 2006, por ajo duhet të ketë qenë rreth 600.000 lekë [...]*. Konstatohet se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, subjekti nuk ka deklaruar shtesë pasurie, vlerën prej 600.000 lekësh, si kursime *cash*.

**30.5** Në Kolegji u krye e njëjta analizë financiare si për vitet 2004 dhe 2005, duke mos i konsideruar kursime *cash* subjektit të rivlerësimit në vitin 2006, për arsye se ai nuk ka deklaruar shtesa dhe pakësime të *cash*-it në deklaratën periodike të vitit 2006. Nga sa më sipër, nga analiza financiare e kryer në Kolegji për vitin 2007, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të krijonte kursime dhe të përballonte shpenzimet për një diferencë negative në vlerën 380.730,91 lekë. Pavarësisht se analiza financiare për vitin 2007 rezultoi me diferencë negative, Kolegji nuk e klasifikoi me efekte negative për subjektin e rivlerësimit këtë shkak ankimi, pasi analiza financiare e këtij viti nuk ishte shkak që ka shërbyer për shkarkim në vendimin e Komisionit.

**30.6** Lidhur me analizën financiare për vitin 2009, rezultoi se, referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë pasurie: (i) vlerën 1.000.000 lekë, në depozitën në Tirana Bank, në emër të bashkëshortes së tij, me burim krijimi shitjen e automjetit në vitin 2008; dhe (ii) vlerën 1.300.000 lekë, si kursime *cash* nga paga e tij dhe e bashkëshortes, të krijuar në periudhën 2008 - 2009. Analiza financiare e Komisionit për këtë vit, rezulton me një diferencë negative në shumën -2.067.681 lekë. Ky rezultat ka ardhur për arsye se Komisioni i ka konsideruar shtesë në kursime në vitin 2009, vlerën 700.000 lekë. Në analizë janë përfshirë të gjitha veprimet në monedhë GBP, të konvertuara me kursin e fundvitit.

Në analizën financiare të kryer në Kolegji për vitin 2009, subjekti i rivlerësimit rezulton me një diferencë negative në vlerën -1.676.302 lekë.

Në analizën financiare në Kolegji, u kryen përlllogaritjet alternative duke e pretenduar si të bazuar shpjegimin e subjektit të rivlerësimit mbi gjendjen *cash* të pretenduar nga ai në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2009, sipas së cilës rezulton se subjekti ka deklaruar: *[...] kam kursyer nga paga e bashkëshortes dhe e imja për vitin 2008 dhe 2009 vlerën 1.300.000 lekë [...]* të cilat deri në datën 30.12.2009 i kam pasur gjendje në shtëpi.

Në analizën ekonomike alternative të kryer në Kolegji, u analizuan të gjitha alternativat dhe mundësitë e kursimeve *cash* në banesë nga subjekti i rivlerësimit. Nëse do të konsiderohej pretendimi i subjektit për krijimin e gjendjes *cash* në banesë në vitin 2009, atëherë situata ekonomike do të rezultonte në diferencën negative -1.076.302 lekë.

**30.7** Në përfundim të analizës së shkakut të ankimit të mësipërm lidhur me analizën financiare të viteve 2005 dhe 2009, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendjen *cash* të këtyre viteve në deklaratimet periodike përkatëse. Nga praktika<sup>11</sup> e konsoliduar e Kolegjit, rezulton se, bazuar në ligjin nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare

---

<sup>11</sup> Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 20/2020, datë 08.09.2020, paragrafi 19.4.

të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, varianti fillestar i pandryshuar, në nenin 4, shkronja “d” parashikohet se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë në ILDKP vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve. Pasaktësitë, për të cilat subjekti justifikohet në shpjegimet gjatë hetimit administrativ, sipas dokumentacionit në dosje, rezultojnë se shoqërohen me mungesën e burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, ndaj nuk konsiderohen si të tilla pikërisht për shkak se përfaqësojnë në fakt mungesë të konsiderueshme burimesh financiare të krijimit të pasurisë së ligjshme. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016. *Sa më sipër, shkak i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, nuk gjendet i bazuar.*

31. Trupi gjykues i Kolegjit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, mbështetur në tërësinë e konkluzioneve të mësipërme dhe në legjisllacionin e zbatueshëm, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen e përcjellë nga Komisioni, si dhe parashtrimet dhe aktet e depozituara në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore, çmoi se vendimi i Komisionit nr. 214, datë 22.11.2019, është i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe si i tillë, duhet lënë në fuqi, pasi:
- I. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 157 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
  - II. Lidhur me analizën financiare për vitet 2005 dhe 2009, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara në këto vite, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
  - III. Sa u përket shkaqeve të tjera të ankimit të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuar nga Kolegji, të cilat rezultuan të bazuara, u vlerësuan si të pamjaftueshme për të ndryshuar/prishur vendimin e Komisionit.
32. Në përfundim, Kolegji, bazuar në vlerësimet e mësipërme, në përputhje me nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të dhe çmon se vendimi i Komisionit nr. 214, datë 22.11.2019, është i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 214, datë 22.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Vrioni.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 27.09.2021, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*